



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:159049

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06354700

KPPP.nr. 887/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, kundër debitorit “Avicena Plus” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811880097 dhe seli në Vrellë, Komuna Lipjan, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 112/24, i lejuar më datë 04.03.2024, nga Përmbaruesi Privat Irfan Kërçagu me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 25.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET, në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Avicena Plus” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811880097 dhe seli në Lipjan, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 112/24, i lejuar më datë 04.03.2024, nga Përmbaruesi Privat Irfan Kërçagu.
- II. Urdhri Përmbarimor P.nr. 112/24, i lejuar më datë 04.03.2024, nga Përmbaruesi Privat Irfan Kërçagu, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, mbi bazën e dokumentit përmbarimor; Vendimit 01 Nr. 25-195/2023, të datës 01.11.2023, ka lejuar Urdhrit Përmbarimor P.nr. 112/24, të datës 04.03.2024, me të cilin është obliguar debitori “Avicena Plus” Sh.P.K., që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj në emër të masës ndëshkimore vlerën prej EUR 1,500.00, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor me arsyetim se kreditori nuk ka arritur të bëjë të besueshëm propozimin për përmbartim duke bërë identifikimin e saktë të debitorit në kuptim të nenit 38, par. 1 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se nuk është bashkangjitur vendimi origjinal apo kopje e vërtetuar, si dhe nuk ka bashkangjitur vendimin Nr. 577/2024, të datës 27.12.2023 të Organit të Shkallës së Dytë. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se propozimin për përmbartim e ka parashtruar si rezultat i mos pagesës së detyrimeve të debitorit në mënyrë vullnetare për pagesë të gjobës së shqiptuar sipas vendimit të formës së prerë të TEIP. Sa i përket pretendimit se debitori nuk ka pranuar vendimin Nr. 577/2024, të datës 27.12.2023 të Organit të Shkallës së Dytë, të njëjtin e ka pranuar përmes email-it të datës 11.01.2024. Ka shtuar se vendimi në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor është i bazuar dhe i ekzekutueshëm. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor përkatësisht vendimin mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi 01 Nr. 25-195/2023, i datës 01.11.2023, mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, është dorëzuar në origjinal dhe i njëjti ka marr formë të prerë dhe mban vulën e ekzekutueshmërisë së datës 27.12.2023, dhe rrjedhimisht i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Nga sa më sipër, bazuar duke u bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 887/24, datë 25.10.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.